



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

SSP.02 STANDARDET E ORGANIZIMIT

SSP.02.01 Standardi i pergjithshem i organizimit

UPT duhet te ofroje arsimim te lartë **inxhinierik** në Republikën e Shqipërisë dhe programe të akredituara të studimeve të larta, në përputhje me kërkesat e zhvillimit **afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë** të vendit.

SSP.02.02 Standardi i njesive perberese organizative

UPT duhet te këtë strukturë bazë:

- Rektorati.
- Fakultetet.
- Insitutet e Kërkimit dhe Zhvillimit.
- Njesi ndihmese.

Rektorati i Universitetit Politeknik te Tiranës duhet te jete i organizuar si më poshtë:

- Sekretaria e Rektorit.
- Dega Mësimore.
- Dega Shkencore.
- Dega e Marredhenieve me jashtë.
- Dega Juridike.
- Dega e Financës.
- Dega e Burimeve Njerezore, akive, protokoll, informacion, statistike.
- Dega e Shërbimeve dhe Investimeve.
- Baza Mekanike per praktikat mesimore.
- Baza e sherbimeve per mjetet e transportit.
- Qendra e sherbimit dhe blerjeve.
- Sektori i sherbimit te rrjetit.
- Qendra e edukimit ne distance.
- Sekretare per senatin dhe Keshillin e Administrimit

SSP.02.03 Standardi i fakultetit, qendrave dhe instituteve te kerkimit dhe zhvillimit, njesive ndihmese

Fakultetet dhe insitutet e kërkimit dhe zhvillimit, si njësi kryesore që bëjnë pjesë në UPT, duhet te jene oragnizuar si me poshte:

Fakulteti i Inxhinierise Mekanike

Departamenti i Prodhimit dhe Menaxhimit
Departamenti i Energjise
Departamenti i Mekanikes
Departamenti i Tekstilit dhe Modes

Fakulteti i Inxhinierise Elektrike

Departamenti i Sistemeve Elektrike te Fuqise
Departamenti i Elektroteknikes
Departamenti i Automatikes

Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit

1. Departamenti i Konstruksioneve te Ndertimit dhe Infrastruktures se Transportit
2. Departamenti i Mekanikes se Strukturave
3. Departamenti i Inxhinierise se Mjedisit
4. Departamenti i Hidraulikes dhe Hidroteknikes

5. Departamenti i Gjeodezise
6. Departamenti i Arkitektures dhe Urbanistikës

Fakulteti i Gjeologjise dhe i Minierave

1. Departamenti i Shkencave te Tokes
2. Departamenti i Gjeologjise se Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikes
3. Departamenti i Inxhinierise se Burimeve Minerare
4. Departamenti i Burimeve te Energjise

Fakulteti i Teknologjise se Informacionit

1. Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit
2. Departamenti i Inxhinierise Informatike
3. Seksioni i Informatikes
4. Qendra e Kerkimit dhe Zhvillimit ne Teknologjite e Informacionit;

Fakulteti i Formimit te Pergjithshem (fakultet i asociuar)

1. Departamenti i Fizikes dhe Kimise
2. Departamenti i Matematikes
3. Qendra e Gjuheve te Huaja

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)

1. Departamenti i Gjeoresurseve dhe Gjeoinxhinierise
2. Departamenti i Gjeofizikes dhe Gjeoriskut
3. Departamenti i Sizmologjise dhe Inxhinierise Sizmike
4. Departamenti i Teknologjive te Gjeoinformacionit

Instituti i Energjise, Ujit dhe Mjedisit (INEUM)

1. Departamenti i Teknologjive Energjetike;
2. Departamenti i Ekonomise se Ujit;
3. Departamenti i Klimes dhe Mjedisit

Njesi ndihmese e UPT

Biblioteka Shkencore.

Qendrave të Kërkimit dhe Zhvillimit që bëjnë pjesë në UPT duhet t'u lind e drejta që të organizohen në grupe kërkimore, si të përhershme ose të përkohëshme.

Titullarët e grupeve të formura brenda Qëndrave të Kërkimit dhe Zhvillimit të UPT, duhet te për zgjidhen me konkurim dhe te emërohen nga Titullari i Qendrës për një kohëzgjatje katër vjeçare ose për periudhën që funksionin grupi.

SSP.02.04 Standardi i departamentit

Veprimet e departamentit duhet te merren kur pjesemarrja ne mbledhjen e pergjithshme te departamentit eshte mbi 2/3 dhe kur shumica vepron pro.

SSP.02.05 Standardi i organeve drejtuese

Organet drejtuese dhe administruese në UPT duhet te jene: senati akademik, rektorati, këshilli i administrimit, këshilli i etikës akademike dhe këshilli i fakultetit/**Institutit**.

SSP.02.06 Standardi i senatit akademik

Funksionet kryesore te senatit duhet te jene:

- i propozon Ministrin te Arsimit dhe Shkencës kuotat e pranimeve në Universitet, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
- kur e çmon të nevojshme, përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;
- përcakton kriteret e pranimit për kandidatët në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve. (Institutet kerkojne te kene te drejte te hapin diploma te ciklit te dyte dhe te trete);
- përzgjedh antaret e Keshillit te etikes akademike;
- shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e këshillit të fakultetit/institutit, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Senati akademik duhet te përbëhet nga 38 anëtarë te zgjedhur + 1 (Rektori) qe le detyren ne zgjedhjet e radhes. Perberja e Senatit duhet te jete:

- Rektori i cili është dhe kryetar i senatit akademik;
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- 4 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
- 3 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
- 3 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- 1 përfaqësues nga personeli administrativ;
- 6 përfaqësues nga studentët- nje perfaqesues nga cdo Fakultet.

Ne mbledhjet e Senatit duhet te mare/marin pjese Zv/rektori (Zv/Rektoret) pa te drejte vote, kur nuk jane te zgjedhur ne senatin akademik.

Dekani/Drejtori i njesise kryesore duhet te jete anëtar i senatit akademik dhe duhet te përfshihet në numrin e përfaqësuesve të çdo fakulteti/instituti.

Senati akademik duhet te kete sekretarin e vet shkencor, i cili duhet te jete Kryetari i Degës Shkencore dhe qe duhet te beje zbardhjen e vendimeve te senatit. Detyrat e tjeta te tij duhet te përcaktohen në rregulloren e brendshme të senatit.

Anëtarët e brendshem te senatit akademik duhet te zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut dhe në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndyshuar. Mandati i anëtarit të Senatit akademik duhet te mbaroje kur:

- a) përmbushet afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) largohet nga UPT;
- d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrrojë funksionin;
- e) kur nuk merr pjesë për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Senatit akademik.

Vendi i mbetur bosh duhet te plotësohet në përputhje me pikën 3.5. të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për periudhën 2007-2011”.

Senati akademik duhet te mblidhet në seanca të zakonshme çdo 2 muaj. Ne fillim te cdo viti akademik duhet te publikohet programi i punes se Senatit. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me iniciativën e Kryetarit të senatit ose me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij. Rendi i ditës duhet te propozohet nga Kryetari dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Në rastet kur senati mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së anëtarëve, rendi i ditës duhet te propozohet nga ky grup anëtarësh dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Vendimet e senatit duhet te jenë të vlefshme vetëm kur në

votim kanë marrë pjesë jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij dhe kur shumica e tyre voton “pro”. Rregullat mbi procedurën e votimit dhe çështje të tjera që lidhen me të, duhet të përcaktohen në rregulloren e brendshme të senatit.

Vendimet e Senatit duhet të behen publike .

SSP.02.07 Standardi i rektoratit

Funksionet kryesore te rektoratit duhet te jene:

- a) harton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin dhe ia paraqet për miratim këshillit të administrimit;
- b) ofron infrastrukturen dhe shërbimin administrativ për mbarevajtjen dhe funksionimin e organeve dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit;
- c) ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e Universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Universitetit.

Detyrat dhe funksionimi i Rektoratit duhet të sanksionohen në Rregulloren e tij të hartuar në përputhje me Statutin e UPT.

SSP.02.08 Standardi i këshillit të administrimit

Funksionet e keshillit të administrimit duhet të jene:

- a) informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë UPT.

Keshilli i administrimit duhet të përbehet nga 17 anetare:

- a) përfaqësues të zgjedhur nga UPT (9 anetare)
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
 - 1 përfaqësues nga studentet
- b) 8 anetare të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kultures, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor;

Mandati i anetarit të Keshillit të Administrimit duhet të mbarojë kur:

- a) përmbushet afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) largohet nga UPT, për ata që janë caktuar sipas pikës 4, shkronjat “a” dhe “c”, të këtij neni;
- d) behet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrimit funksionin;
- e) kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Keshillit të Administrimit;
- f) për anetarët që janë emeruar, kur lirohen me akt të ministrit.

Vendi i mbetur vakant për anetarët që zgjidhen nga personeli akademik, duhet të plotësohet në përputhje me pikën 3.5. të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për periudhën 2007-2011”.

Menyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to duhet të parashikohen në rregulloren e brendshme të Keshillit të Administrimit.

SSP.02.09 Standardi i këshillit te etikës

Keshilli i etikes akademike te UPT duhet te perbehet nga:

- a) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
- b) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
- c) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
- d) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- e) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- f) 1 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
- g) 1 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
- h) 1 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- i) 1 përfaqësues nga studentet.

Antaret e Keshillit akademike duhet te zgjedhin kryetarin e tij .

Keshilli i etikes akademike duhet te hartoje rregulloren e etikes se universitetit e cila duhet te miratohet nga Senati akademik i UPT.

SSP.02.10 Standardi i keshillit te fakultetit dhe institutit te kerkimit dhe zhvillimit

Keshilli i fakultetit duhet te ushtroje edhe keto kompetenca:

- miraton rregulloren e fakultetit;
- i paraqet Rektoratit strukturen dhe numrin e punonjesve ne fakultet;
- shpall projektet fituese, per t'u financuar nga fondet per kerkim shkencor nga buxheti i fakultetit, si dhe bursat per studime shkencore, qe administrohen nga vete fakulteti;
- miraton listen e periodikeve shkencore ku do te pajtohet fakulteti, si dhe titujt e librave qe do te blihen per biblioteken e fakultetit;
- miraton menyren e perdorimit te dhurimeve qe jane kryer ne favor te nje departamenti, duke marre parasysh propozimin e departamentit perfitues;
- ushtron edhe kompetenca te tjera qe percaktohen ne Rregulloren e UPT apo te fakultetit, bazuar ne specifiket e seicilit fakultet.

Ne ushtrimin e kompetencave te tij keshilli i fakultetit duhet te shprehet me vendime.

Keshilli drejtues i Institutit te kerkimit dhe zhvillimit duhet te kete keto kompetenca:

- harton kuadrin rregullator te veprimtarise se institutit;
- pergatit strukturen dhe organiken e institutit dhe ia paraqet per miratim Rektorit;
- harton planin afatgjate te zhvillimit te Institutit dhe ia paraqet per miratim, Senatit Akademik;
- percakton fushat paresore te kerkimit dhe, ne varesi te tyre, i propozon Senatit Akademik grupet kerkimore-mesimore, qe do te ngrihen ne institut;
- percakton kriteret e punesimit te personelit akademik, per fazen kalimtare, sipas VKM Nr. 560 dhe 561, date 22.03.2007;
- drejton procedurat e konkurimit te hapur, per emerimin e titullareve te grupeve kerkimore-mesimore, per fazen kalimtare;

SSP.02.11 Standardi i keshillit te profesoreve

Profesori qe merr pjese ne keshillin e profesoreve te nje fakulteti, mund te jete anetar i dy keshillave.

SSP.02.12 Standardi i autoriteteve drejtuese në UPT

Rektori duhet te ushtroje keto funksione:

- Drejton universitetin ne te gjitha aspektet e veprimtarise se tij akademike, kerkimore e shkencore, administrativo-financiare.

- Drejton hartimin e planit strategjik te zhvillimit te institucionit dhe ndjek zbatimin e tij.
- Paraqet propozimet per aktet qe jane ne kompetence per t'u shqyrtuar nga Senati Akademik, Keshilli i Administrimit apo Keshilli i Etikes Akademike.
- Nenshkruan ne emer te UPT marreveshje e protokolle bashkepunimi me universitetet e tjera, vendase dhe te huaja, dokumentacione per anetaresimin e UPT ne shoqata dhe organizata kombetare dhe nderkombetare te arsimit te larte, marreveshje bashkepunimi me subjekte vendase dhe te huaja qe ndihmojne ne zhvillimin e arsimit te larte. Keto marreveshje, protokolle e bashkepunime i paraqiten Senatit per ratifikim.
- Perfaqeson UPT ne marredhenie me te tretet.
- Si kryetar i Senatit, ka te drejten e vetos mbi vendimin e tij, duke ia kthyer ketij organi per rishqyrtim. Kur Senati, mbas rishqyrtimit, nuk e ndryshon vendimin, ky vendim tashme eshte i formes se prere.
- Shfuqizon, kryesisht apo me kerkesen e te interesuarit, aktet e dekanit/drejtorit , kur bien ndesh me legjislacionin ne fuqi.
- Miraton strukturen dhe organiken e personelit te Universitetit.
- Emeron punonjesit e personelit akademik, kryetaret e degeve dhe specialistet ne rektorat, duke iu permbajtur kriterëve per zenien e ketyre vendeve.
- Nenshkruan kontratat e punes me punonjesit akademike dhe administrativ.
- Nenshkruan diplomat e ciklit te pare, te dyte dhe te trete, pa te drejte per te deleguar nenshkrimin.
- Ngre komisione e grupe pune per çeshtje, studime e veprimtari te veçanta.

Mandati i Rektorit duhet te mbaroje kur:

- a) perfundon afati i mandatit;
- b) jep doreheqjen;
- c) behet i pamundur nga ana fizike apo mendore te ushtroje funksionin;
- d) ne rastin e parashikuar ne piken 3, te nenit 64, te ligjit nr. 9741, date 21.05.2007 "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise".

Marredheniet e Rektorit me organet e tjera, menyra dhe kushtet e ushtrimit te kompetencave te tij duhet te parashikohen ne rregulloren e Rektoratit dhe te UPT .

Dekani/drejtori duhet te kryeje keto funksione :

- pergatit propozimin perkates per çdo vendimarrje te Keshillit te njesise kryesore;
- pergjigjet para keshillit te njesise kryesore per mbarevajtjen e aktivitetit te njesise;
- i propozon (Keshillit te Fakultetit) hapjen, mbylljen e programeve te studimit si dhe reformimin e kurrikulave, te departamenteve apo njesive te veçanta ne fakultet.

Dekani/Drejtori ne ushtrim te kompetencave te tij, duhet te shprehet me urdhra dhe udhezime.

Marredheniet e Dekanit /Drejtorit me organet e tjera, menyra dhe kushtet e ushtrimit te kompetencave te tij duhet te parashikohen ne rregulloren e njesise kryesore.

Pergjegjesi i Departamentit / Qendres se kerkimit dhe zhvillimit duhet te jete autoriteti drejtues i njesise baze

Pozita juridike e pergjegjesit te departamentit/qendres se kerkimit dhe zhvillimit, marredheniet e tij me personelin akademik, me organet e tjera, si dhe me te tretet, duhet te percaktohen ne rregulloren e njesise kryesore.

SSP.02.13 Standardi i zgjedhjes se organeve dhe e autoriteteve drejtuese ne UPT

Perberja e keshillave te njesive kryesore dhe menyra e perfaqsimi te cdo njesie baze ne to, duhet te percaktohen ne Rregulloret e funksionimit te njesive kryesore.

SSP.02.14 Standardi i autoriteteve të tjera të UPT

Procedura e emerimit apo e shkarkimit te Zv/Rektorit duhet te percaktohen ne Rregulloren e funksionimit te UPT.

Zevendesrektorit duhet te kryeje funksionet e percaktuara ne Rregulloren e UPT.

Ne mungese dhe me porosi te Rektorit, ai duhet te nenshkruaje aktet perkatese ne emer te UPT.
Kancelari duhet te ushtroje keto funksione:

- a) pergjigjet per veprimtarine ekonomike dhe financiare te Universitetit, me perjashtim te kompetencave ekskluzive te Keshillit te Administrimit;
- b) propozon studime per zhvillimin perspektiv te Universitetit;
- c) organizon kryerjen e kontroll-revizionit financiar te Universitetit;
- d) perfaqeson UPT si firme e pare e deleguar nga Rektori ne marredheniet financiare me Banken e Shtetit dhe ne te gjitha marredheniet kontraktore me te tretet, brenda fushave qe ai mbulon;
- e) therret ne raport kancelaret dhe kryetaret e degeve ekonomike ne njesite kryesore;
- f) Funksionet e Kancelarit percaktohen ne Rregulloren e Rektoratit dhe te UPT.

Funksionet dhe procedura e emerimit/shkarkimit te zevendesdekanit/zevendesdrejtorit percaktohen ne rregulloren e njesise kryesore .

Funksionet e kancelarit te njesise kryesore duhet te percaktohen ne rregulloren e njesise kryesore